

Dr. Musli Vërbani

DJALI E PYET BABAIN PËR...

Kaçanik, 2023

DJALI E PYET BABAIN PËR ISRANË

Djali: Çka do të thotë ISRA?

Babai: Isra do të thotë udhëtim nate.

Djali: Pse ka ndodhë udhëtimi natën?

Babai: Ashtu sikurse Kurani ka filluar të zbres në natën e Kadrit ashtu edhe ISRA-ja ka ndodhë natën. nata ka vlerë dhe rëndësi më të madhe se dita.

Djali: Çka do të thotë ESRA?

Babai: Do të thotë se është bartur.

Djali: Me çka është bartur?

Babai: Është bartur me Burak.

Djali: Çka do të thotë Burak?

Babai: Buraku është kafshë me shpejtësi të madhe të cilën Xhibrili e ka sjellë posaçërisht për Pejgamberin a.s.

Djali: E kush është Xhibrili?

Babai: Melaqja e cila ia ka sjell Kuranin Muhamedit a.s.

Djali: E çfarë udhëtimi ka bërë Muhamedi a.s.?

Babai: Ka udhëtuar nga Meka në Jerusalem.

Djali: Çka ka në Meke?

Babai: Në Meke është Qabja e madhëruar.

Djali: E çka ka në Jerusalem?

Babai: Në Jerusalem është Mesxhidi Aksa.

Djali: Atëherë, ISRA do të thotë Udhëtim nga Qabja deri në Mesxhidi Aksa?

Babai: Po, ISRA nënkupton se është bartur nga Mesxhidi Harami i Mekës në Mesxhidi Aksa të Jerusalemit.

Djali: Unë e di se Qabja është shtëpia e parë e cila është ndërtuar për t'u adhuruar Zoti nga njerëzit!?

Babai: Ndërsa, Mesxhidi Aksa është ndërtuar pas 40 viteve, pra edhe Mesxhidi Aksa daton nga koha e Adem-it a.s.?

Djali: Po a nuk e ka ndërtuar Sulejmani a.s.?

Babai: Po sikurse i ka ngritë Ibrahim-i themelet e Qabës ashtu i ka ngritë themelet edhe stërnipi i Ibrahim-it a.s. Sulejmani a.s. themelet e Mesxhidi Aksasë.

Djali: Kur ka shkuar Në Mesxhidi Aksa, çka ka vepruar pejgamberi a.s.?

Babai: I ka falë dy rekate namaz.

Djali: Ato dy rekate i ka falë vetëm apo me xhematë?

Babai: Jo, nuk i ka fal vetëm por me xhematë dhe ka qenë Imam i të gjithë pejgamberëve?

Djali: Çfarë simbolike ka çështja se është bërë Imam i pejgamberëve?

Babai: Nga shkaku se Muhamedi a.s. është vula e pejgamberëve.

Në fund babi i thotë të birit:

“Biri im: Mos harro se nga Mesxhidi Aksa-ja pejgamberi a.s. është ngritë në hapësirat më të larta qiellore, ku përpos Mesxhidi Aksa-së është edhe Mesxhidi Sahra, i cili Mesxhid është pika qendrore e ngritjes së Pejgamberit a.s. në qiell, i cili është brenda përbrenda hapësirës së Mesxhidi Aksa-së së bekuar.

DJALI E PYET BABAIN PËR MIRAXHIN

Djali: Çka do të thotë Miraxhë?

Babai: Miraxhë do të thotë ngritje.

Djali: A mos do të thotë ngritje në maje të larta të tokës!?

Babai: Jo biri im, Miraxhë do të thotë ngritje në hapësirat më të larta qiellore.

Djali: Pejgamberi a.s.,kur është ngritë në qiell, a ka shkuar vetëm me shpirt apo?

Babai: Jo biri im, ka shkuar edhe me trup edhe me shpirt.

Djali: Me kë është takuar Muhamedi a.s. në qiellin e parë?

Babai: Në qiellin e parë të kësaj bote Muhammedit a.s. është takuar me Ademin a.s.

Djali: Me kë është takuar Muhamedi a.s. në qiellin e dytë?

Babai:Në qiellin e dytë është takuar me dy pejgamberët: Isa a.s. dhe Jahja a.s.

Djali: Me kë është takuar Muhamedi a.s. në qiellin e tretë?

Babai: Në qiellin e tretë është takuar me simbolin e bukurisë, Jusufin a.s.

Djali: Me kë është takuar Muhamedi a.s. në qiellin e katërt?

Babai: Në qiellin e katërt është takuar me Idrisin a.s.

Djali: Me kë është takuar Muhamedi a.s. në qiellin e pestë?

Babai: Në qiellin e pestë është takuar me Harunin a.s.

Djali: Me kë është takuar Muhamedi a.s. në qiellin e gjashtë?

Babai: Në qiellin e gjashtë është takuar me Musain a.s..

Djali: Me kë është takuar Muhamedi a.s. në qiellin e shtatë?

Djali: Në qiellin e shtatë është takuar me Ibrahimin a.s i cili ka qenë i mbështetur në shpinë në Bejtu El-Maëmurë?

Djali: Pastaj, ku ka shkuar pejgamberi a.s?

Babai: Pastaj, Muhamedi a.s. është ngritë deri në Sidretul Munteha.

Djali: Çka do të thotë Sidretul Munteha?

Babai: Sidretul Munteha është pemë, në pikën më të lartë të hapësirave qiellore, me fjalë tjera aty ku përfundojnë krijesat.

Djali: Pse ka shkuar në Sidretul Munteha?

Babai: Në Sidretul Munteha ka shkuar për të biseduar me Zotin.

Djali: Si e ka përshëndet Pejgamberi a.s. Zotin e Madhëruar?

Babai: Pejgamberi a.s e ke përshëndetë me përshëndetjen:

“ETTEHIJATU LILAHIVES-SALAVATU VET-TAJJIBATU”.

Djali: Si e ka përshëndetë Zoti i Lartmadhëruar pejgamberin a.s.?

Babai: Me përshëndetjen:

“ESSELAMU ALEJKUM EJJUHEN NEBIJUVE RAHMETULLAHI VE BEREKATUHU”.

Djali: Si i është përgjigj Pejgamberi a.s.?

Babai: Me përshëndetjen:

“ESSELAMU ALEJNAVE ALA I BADIL-LAHI SALIHINË”.

Djali: Çka ka thënë Xhibrili kur e ka dëgjuar këtë bisedë?

Babai: Xhibrili ka thënë:

“ESHHEDU EN LA ILAHE IL-LA-LLAHU

VE ESHHEDU ENNE MUHAMEDEN ABDUHU VE RESULUHU”.

Djali: A nuk është kjo lutja të cilën e këndojmë ulur në çdo namaz?

Babai: Po, nga MIRAXHI peygamberi a.s. na ka sjellë dhuratën më të çmuar: NAMAZIN, i cili simbolizon edhe lidhjen e njeriut me Zotin e Madhërishëm për këtë arsye ne e këndojmë në uljen e fundit të çdo namazi.

DJALI E PYET BABAIN PËR RAMAZANIN

Djali: Çka do të thotë Ramazan?

Babai: Fjala Ramazan është emër i muajit Kalendarik.

Djali: Po unë po i numëroj muajt e vitit: Janar, Shkurt, Mars Prill ...Dhjetorë, por nuk po e shoh se ka muaj me emrin Ramazan.

Babai: Këto janë muajt e Kalendarit Diellor ndërsa muajt kalendarit Hënorë janë: Muharrem, Safer, Rebiul Evvel, Rebiul Ahir, Xhumadal Ula, Xhumadal Ahir, Rexhep, Shaban, Ramazan, Sheval, Dhul Kaëde dhe Dhul Hixhe.

Djali: Sa ditë i ka viti në bazë të Kalendarit diellor?

Babai: 365 ditë.

Djali: Sa ditë i ka viti në bazë të Kalendarit hënor?

Babai: 355 ditë.

Djali: Kur ka filluar numërimi i viteve në Kalendarin diellor?

Babai: Në bazë të lindjes së Isa a.s.

Djali: Kur ka filluar numërimi i viteve në bazë të kalendarit hënor?

Babai: Me vitin e parë të hixhretit të Muhamedit a.s.

Djali: A përmendet muaji Ramazan në Kuran?

Babai: Po, Zoti i Lartmadhërishëm thotë:

“Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin ka zbritë Kur’ani...”

Djali: Kur fillon muaji i Ramazanit?

Babai: Me paraqitjen e hënës së re, me fjalë tjera kur hëna bëhet në formë thupre.

Djali: Kur përfundon muaji Ramazan?

Babai: Kur hëna (në vijim) bëhet e re, me fjalë tjera kur bëhet prapë në formë thupre.

Djali: Pse është përzgjedhë muaji Ramazan për t'u agjëruar?

Babai: Nga shkak se në këtë muaj ka filluar zbritja e Kuranit.

Djali: Në cilën natë të muajit Ramazan ka filluar zbritja e Kur'anit?

Babai: Në natën e Kadrit e cila është më e vlefshme se një mijë muaj.

Djali: Çka konsiderohet agjërimi i muajit Ramazan?

Babai: Agjërimi i muajit Ramazan është shtylla e katërt e Islamit.

Djali: Kur është bërë obligim agjërimi i muajit Ramazan?

Babai: Agjërimi i muajit Ramazan është bërë obligim në muajin Shaban të vitit të dytë të hixhretit të Muhamedit a.s.

Djali: Nëse agjëroj, kur duhet të ndërpres ushqimin?

Babai: Në Imsak, me fjalë tjera para lindjes së diellit.

Djali: E prej cilit moment duhet të filloj të ushqehem, me fjalë tjera ta plotësoj ditën e agjërit?

Babai: Kur fillon iftari, me fjalë tjera pas perëndimit të diellit.

Djali: Çka lejohet prej akshamit (IFTARIT) deri para mëngjesit (IMSAKUT)?

Babai: Të gjitha çështjet e ndaluara gjatë ditës bëhen të lejuara.

Djali: Nëse jam i sëmurë, apo në fazën e pleqërisë së rëndë, a kam të drejt të mos agjëroj?

Babai: Zoti dëshiron lehtësim dhe jo vështirësim, përpos këtyre rasteve mund të mos agjërosh edhe nëse je në udhëtim apo edhe nëse alivanosesh për shkak të urisë.

Djali: A ka edhe raste tjera ku lejohet mosagjërimi?

Babai: Po, shtatzënia; Gruaja e cila i jep gji fëmijës; Gruaja me menstruacion dhe lehona, mirëpo ato ditë i plotësojnë më vonë (KADA).

Djali: A mund të agjëroj ditë tjera përpos ditëve të muajit Ramazan?

Babai: Po, mund të agjërosh agjërim vullnetar ndërsa agjërimi vullnetar më i miri është agjërimi i Davudit a.s. i cili në vazhdimësi gjatë gjithë vitit e agjëronte një ditë dhe nuk agjëronte ditën tjetër.

DJALI E PYET BABAIN PËR ZEKATIN

Djali: Çka do të thotë zekat?

Babai: zekat do të thotë: Pastrim dhe shtim i pasurisë.

Djali: Fjalën pastrim po e kuptoj, po nuk po e kuptoj si mund të shtohet pasuria kur jepet!?

Babai: Nga shkakut se njeriu është krijesë shoqërore dhe kur njeriu i jep shoqërisë ai e ka zhvilluar shoqërinë dhe kur zhvillohet shoqëria zhvillohet edhe individ. Dihet se edhe tjetri është pjesë e shoqërisë ku bënë pjesë edhe ti.

Djali: Çka konsiderohet zekati në islam?

Babai: Zekati në islam është farz, kush nuk e jep është mëkatar i madh.

Djali: Si cilësohet ai i cili e mohon obligueshmërinë e zekatit?

Babai: Kush e mohon dhënien e zekatit ai është pabesimtarë nga shkakut se zekati është shtyllë prej shtyllave të islamit.

Djali: Kur duhet të jap zekat?

Babai: Kur të kesh pasuri mbi NISABIN.

Djali: Çka do të thotë NISAB?

Babai: Limiti kur të bëhet obligim zekati.

Djali: Cili është ai limiti?

Babai: 91 gram të arit.

Djali: Sa duhet të jap zekatë?

Babai: 2.5 % nga pasuria e cila nuk ka qarkulluar gjatë një viti.

Djali: Zekati jepet vetëm në ari dhe në argjend apo edhe për produkte tjera.

Babai: Zekati në ari, në argjend, në mall tregtie, në kafshë shtëpiake jepet 2.5% ndërsa në produktet tjera jepet më shumë.

Djali: Sa duhet të jap zekat për produkte bujqësore?

Babai: Në pemë, në perime, në produkte bujqësore jepet 5% dhe 10%.

Djali: Kur jepet 5% dhe kur jepet 10%?

“Çka e ka ujitur qielli me shi jepet 10 % zekat, ndërsa arat apo plantacionet të cilat nevojiten të ujitën me mjete pune apo me mjete teknologjike zvogëlohet përqindja e zekatit prej 10 % në 5 %. për arsye se shpenzohet mund dhe angazhim.

Djali: Sa duhet të jepet zekati në thesar dhe në xehe?

Babai: Në thesar dhe në xehe zekati jepet 20 %.

Djali: Zekatin duhet ta jap vetëm për të varfrit dhe për të gjoburit apo i takon edhe të tjerëve?

Babai: Përpos të varfërve dhe të gjoburëve, zekati u takon edhe nëpunësve të cilët shpenzojnë mund dhe kohë për administrimin e zekatit.

Djali:Përpos nëpunësve të zekatit a i takon zekati edhe ndokujt tjetër?

Babai: Zekati është edhe për të përhapë fenë islame për këtë arsye u jepet edhe jomuslimanëve për të përfituar zemrat e tyre.

Djali: Sa po e kuptoj zekati jepet për shumë kategori!?

Babai:Po biri im, zekati jepet edhe për lirimin e robërve, po ashtu edhe për të ngarkuarit në borxhe që në gjuhën e sodit quhet: Për të falimentuarit në tregti.

Djali: Babi, unë po e kuptoj se zekati është institucion i lartë islam?

Babai: Biri im, për këtë arsye zekati jepet edhe në rrugën e Allahut (për forcimin e ushtrisë së atdheut) dhe për udhëtarët të cilët kanë mbetur në rrugë pa mjete materiale.

Djali: A e japin zekatin vetëm të pasurit apo edhe të varfrit?

Babai: Përpos zekatit të pasurisë e kemi edhe zekatin e trupit (Zekatul Fitrin) të cilin e japin edhe të pasurit edhe të varfrit. Këtë lloj të zekatit e japin muslimanët në fund të muajit Ramazan ashtu që, që të gjithë ta presin Festën e Bajramit me gëzim dhe të lumtur.

Në fund djali i thotë babait: Babi unë jam i lumtur që i takoj fesë islame ngase Feja Islame është edhe fe humane, përkujdeset për të gjitha shtresat e shoqërisë ashtu që të gjithë të jetojnë në harmoni dhe të bashkuar.

DJALI E PYET BABAIN PËR NAMAZIN

Djali: Çka është namazi?

Babai: Namazi është Shtylla e dytë e Islamit.

Djali: Pse duhet marrë abdes para se të falemi?

Babai: Nga shkaku se Pastërtia është pjesë e imanit dhe Zoti i do pendimtarët dhe të pastrit.

Djali: Pse duhet falë pesë herë në ditë?

Babai: Nga shkaku se nëse pastrohesh në ndonjë lumë pesë herë në ditë atëherë nuk të mbetet asnjë njollë në trup ngase falja e pesë kohëve i zhdukë njollat e mëkateve dhe të largon nga të këqijat.

Djali: Pse kur falemi duhet të drejtohem në drejtim të Qabës?

Babai: Nga shkaku se është shtëpia e parë në fytyrën e tokës e cila është ndërtuar për t'u adhuruar Allahu.

Djali: Me cilën fjalë e fillojmë namazin?

Babai: Me fjalën: “Allahu Ekber” (Allahu është më i madhi).

Djali: Cila sure është e domosdoshme të lexohet gjatë qëndrimit në këmbë në Namaz?

Babai: Suretul Fatihah

Djali: A ma mëson suretull Fatihah-në?

Babai: Po biri im, përsërite pas meje:

BISMIL-LAHIRRAHMANIRRAHIM ELHAMDU LILAHIR
RABBIL ALEMIN ERRAHMANIRRAHIM MALIKI JEVMID DIN
IJJAKE NEABUDU VE IJJAKE NESTEIN IHDINES SIRATAL
MUSTEKIM SIRATAL LEDHINE ENAMTE ALEJHIM GAJRIL
MAGDUBI ALEJHIM VE LED DAL-LIN

Djali: A ma mëson edhe ndonjë sure të shkurtë e cila më nevojitet për namaz?

Babai: Po biri im përsërite pas meje:

KUL HUVALLAHU EHAD ALLAHU SAMED LEM JELID VE LEM
JULED VELEM JEKUN LEHU KUFUVEN EHAD

Djali: Çka duhet të themi në rukuë?

Babai: “Subhane Rabbiel Adhimë”

Djali: Çka duhet të themi në sexhde?

Babai: “Subhane Rabbiel eala”.

Djali: Në uljen e fundit çka duhet të këndojmë?

Babai: Lutjen e përshëndetjes (Ettehiyatun)

Djali: A ma mëson Ettehijatin (Lutjen e përshëndetjes)

Babai: Po biri im përsërite pas meje:

ETTEHIJATU LILAHIVES-SALAVATU VET-TAJJIBATU.
ESSELAMU ALEJKUM EJJUHEN NEBIJUVE RAHMETULLAHI VE
BEREKATUHU.

ESSELAMU ALEJNAVE ALA I BADIL-LAHI SALIHINË.

Djali: Babi, A mund ta vazhdoj unë me shehadetin!?

Babai: Vazhdoje biri im.

Djali:ESHHEDU EN LA ILAHE IL-LA-LLAHU

VE ESHHEDU ENNE MUHAMEDEN ABDUHU VE RESULUHU.

Babi: Përpos kësaj mund të vazhdosh edhe me SALAVATET dhe DUAT por që nuk janë Farz të këndohen (të cilat do t'i mësoj më vonë).

Djali: Me cilën thënie përfundojmë namazin?

Babai: Me thënien “Esselamu alkejkum ve rahmetull-Llah”.

Djali: Çka quajmë namaz farz?

Babai: Atë që e ka urdhëruar Allahu i Madhërishëm.

Djali: Çka quajmë namaz sunet?

Babai: Atë që e ka praktikuar dhe e ka sugjeruar pejgamberi a.s.

Djali: Përpos namazeve ditore a kemi namaz tjetër?

Babai: Po, e kemi namazin javorë, Namazin e xhumasë.

Djali: A kemi namaz vjetor?

Babai: Namaz vjetor janë namazet e Bajrameve, miëpo përpos këtyre kemi edhe namaze tjera vullnetare të cilat do t'i mësosh me kalimin e kohës.

Djali: Pse thonë se nuk falem se lutjet janë të vështira dhe nuk mund t'i ndajnë rekatet?

Babai: Nga shkaku se ai i cili nuk dëshiron të falet gjen arsye të pabazuara.

Në fund babai i thotë të birit: Biri im falu sa të jesh gjallë e mos lejo që të ta falin namazin për ty ndërsa t'i asnjëherë nuk ke falë namaz për vetën tënde.

DJALI E PYET BABAIN PËR SEHABET

Djali: Çka do të thotë SEHABE?

Babai: Sehabe ka kuptim të gjerë dhe kuptim të ngushtë.

Djali: Çka nënkupton SEHABE në kuptim të gjerë?

Babai: Çdo shokë i çdokujt.

Djali: Çka nënkupton SEHABE në kuptim të ngushtë?

Babai: Çdo shok i Muhamedit a.s.

Djali: A ka pas shumë SEHABE Muhamedi a.s.?

Babai: Po, Muhamedi a.s. ka pas shumë sehabe.

Djali: Sa ka qenë numri i SEHABEVE të Muhamedit a.s.?

Babai: Muhamedi a.s. ka pas shokë, një pjesë e tyre ka qëndruar shumë me Muhamedin a.s. dhe një pjesë e tyre ka qëndruar vetëm në ndonjë tubim. Kusht është që këta SEHABE të kenë qenë të moshës madhore dhe muslimanë.

Djali: Sa ka qenë numri i SEHABEVE të ngushtë?

Babai: Numri i tyre fillon prej 313 SEHABEVE të cilët kanë marrë pjesë në betejën e Bedrit e më shumë e më shumë.

Djali: Sa ka qenë numri i SEHABEVE në përgjithësi?

Babai: Edhe pse nuk dihet numri i saktë i tyre por numri i tyre ka kaluar mbi 100 000 të cilët kanë marrë pjesë në çlirimi e Mekës

Djali: Cilët kanë qenë SEHABET më eminent të Muhamedit a.s.?

Babai: Sehabet më eminent kanë qenë Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu r.a.

Djali: A e kanë dashtë Muhamedin a.s. SEHABET?

Babai: Po, Sehabet kanë qenë në gjendje të japin gjithë pasurinë për Muhamedin a.s. dhe për misionin e tij.

Djali: Si janë quajtur SEHABET të cilët kanë lënë gjithë pasurinë për të vazhduar rrugën e Muhamedit për ta përhapë fenë islame?

Babai: Ata sehabë janë quajtur MUHAXHIR.

Djali: Si janë quajtur SEHABET të cilët i kanë ofruar vendstrehim Muhamedit pasi është dëbuar nga vendlindja e tij prej idhujtarëve?

Babai: Ata sehabë janë quajtur ENSARË.

Djali: A i ka dashtë SEHABET Muhamedi a.s.?

Babai: Po, i ka dashtë Sehabet, por edhe për ty biri im ka qarë Muhamedi a.s.

Djali: Pse!? A ka qarë për mua Muhamedi a.s.?

Po, ka qarë për ty Muhamedi a.s.

Djali: Pse ka qarë për mua Muhamedi a.s.?

Babai: Pse SEHABET i ka quajtur SEHABE ndërsa ty të ka quajtur VËLLA, për këtë arsye ka qarë.

Pastaj babai i thotë Djalit të tij:

Deri sa Pejgamberi a.s. ishte duke marrë abdes ju ka thënë SEHABEVE: Ju jeni SEHABET e mi, ju më shihni dhe ju shoh por po qaj për vëllezërit e mi të cilët do të vijnë në gjeneratat mëvonshme të cilët edhe pse nuk më shohin do të më besojnë sikurse të më kishin pa dhe do të marrin abdes sikurse unë.

Djali i tha Babit: Babi, unë e dua Muhamedin a.s. dhe do ta ndjek rrugën e tij gjatë gjithë jetës sime.

DJALI E PYET BABAIN PËR “SELAMIN”

Djali: Çka është SELAMI?

Babai: Është përshëndetje islame.

Djali: Çka do të thotë SELAM?

Babai: SELAM do të thotë paqja qoftë mbi ju.

Djali: Më gjerësisht, çfarë kuptimi ka kjo përshëndetje Islame?

Babai: Islami është për të dy botët, për këtë arsye edhe përshëndetja bëhet për të i dëshiruar njëri tjetrit paqe, shpëtim dhe lumturi (SELAM) edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, për këtë arsye bëhet përshëndetja me SELAM.

Djali: Kur ka ndodhë SELAMI i parë?

Babai: Prej babës së njerëzimit Ademit a.s: “Zoti kur krijoi Ademin a.s. i ka thënë: O Adem, shko dhe përshëndete atë grup melekësh që janë ulur dhe mbaje mend përshëndetjen që do ta kthejnë ato, sepse ajo është përshëndetje që do të vlejë edhe për ty edhe për pasardhësit tu. Ademi a.s. shkoi dhe i përshëndeti melekët me SELAM, kurse ata ia kthyen SELAMIN”.

Djali: A jepet SELAM në shtëpinë tende apo në shtëpi tjetër kur nuk ka njeri në të?

Babai: Po, ai i cili hyn në shtëpi ku nuk ka njeri duhet të përshëndet me SELAM.

Djali: A jepet SELAMI kur hymë në ndonjë vend tubim?

Babai: Po, kur dikush nga ju hyn në një kuvend, jep SELAM edhe pse ata janë ulur.

Djali: Po, a jepet selami kur largohemi nga ai tubim?

Babai: Sikurse jepet selam kur hynë në ndonjë tubim, ashtu edhe kur të largohesh nga tubimi jepet selam.

Djali: A jepet selami në rrugë?

Babai: Kur të takohen në rrugë dy musliman në mes vete i japin SELAM njëri-tjetrit.

Djali: A mund të jap selam nga Automjeti?

Babai: Nëse ndodhësh në automjet ti i jep selam i pari këmbësorit.

Djali: Nëse jam duke ecur a më lejohet t'i jap selam të ulurit?

Babai: Po, këmbësori i jep selam të ulurit, ndërsa i uluri ulur ia kthen selamin këmbësorit.

Djali: Nëse takohet grupi i vogël grupin e madh cila grupë jep selam i pari?

Babai: Grupi i vogël i jep selam grupit të madh.

Djali: Nëse takohen i riu me të moshuarin kush jep SELAM i pari?

Babai: I riu i jep selam të moshuarit.

Djali: Kur nuk është e pëlqyeshme dhënia e selamit?

Babai: Nuk është e pëlqyer të jepet SELAM kur dikush lexon Kur'an ose është duke u falur ngase ai është duke kryer obligim tjetër.

Djali: Po nëse nuk është duke krye ndonjë obligim, a ka rast tjetër ku nuk jepet SELAM?

Babai: Nuk përshëndetet me SELAM tjetri i cili është në nevojtoire, ose është lakuriq në banje, ose kur është në gjumë.

Babi: Djali: A ka edhe ndonjë rast tjetër, përpos këtyre rasteve?

Babai: Nuk i jepet selam atij që është duke bërë mëkat si p.sh. duke pi alkool ose është luajtur bixhoz ose në raste të ngjashme, sepse ato vepra janë vepra të mëkatit, ndërsa selami është vepër devotshmërie.

Djali: A i jepet selam të vdekurve në varreza?

Babai: Po. Gjatë kalimit rreth varrezave, minimumi që duhet thënë është: “ESSELAMU ALEJKUM - O ju shtëpi të besimtarëve”.

Djali: Si do të përshëndeten muslimanët në mes vete në Xhenet?

Babai: Do të përshëndeten me SELAM. Zoti thotë:

“Atje (në xhennet) ata nuk do të dëgjojnë ndonjë fjalë të kotë, por vetëm fjalën “SELAM”!” (Merjem, 62)

Djali: A i përshëndet edhe ndokush tjetër me fjalën SELAM në Xhennet.

Babai: Për banorët e xhenetit Zoti thotë:

“Melekët do të hyjnë pranë tyre(banorëve të xhenetit) nga të gjitha dyert dhe do t’i përshëndesin: “SELAMUN ALEJKUM për atë që keni duruar!” (Er-Rad, 23-24)

Djali: Në Xhennet si do t’i përshëndet Zoti besimtarët?

Babai: Zoti do t’i përshëndet me SELAM. Zoti në Kur’an thotë:

“SELAMI do të jetë nga Zoti i tyre Mëshirues!” (JaSinë: 58)

DJALI E PYET BABAIN PËR HIXHRETIN

Djali: Çka do të thotë HIXHRET?

Babai: HIXHRET do të thotë migrim, shpërngulje.

Djali: Çka quajmë migrim të Muhamedit a.s?

Babai: Migrimi i pejgamberit Muhammedit është migrimi i tij nga Meka në Medine.

Djali: Në cilin vit ka migruar pejgamberi a.s.?

Babai: Më 12 të muajit Rebiul-Evvel, gjegjësisht më 24 Shtator 622.

Djali: A ka migruar pejgamberi a.s. për pasuri?

Babai: Jo, nuk ka migruar për pasuri.

Djali: A ka migruar për jetë më të mirë?

Babai: Jo, nuk ka migruar përjetë më të mirë.

Djali: Atëherë, për çka ka migruar?

Babi: Për të themeluar shtetin Islam.

Djali: Kur ka ndodhë migrimi i parë në histori të njerëzimit?

Babai: Hixhreti (migrimi) i pari në historinë e pejgamberëve a.s. është hixhreti i Nuhut a.s.

Djali: Pse ka ndodhë migrimi i Nuhut a.s.?

Babai: Migrimi i Nuhut a.s. është bë për të shpëtuar a pasuesit e tij, dhe për t'u shkatërruar pabesimtarët kryeneç të cilët talleshin me të.

Djali: A kanë migruar edhe ndonjë prej pejgamberëve tjerë?

Babai: Po, ka migruar Ibrahimit a.s.; Jakubit a.s; Musa a.s. por edhe pejgamberë të tjerë.

Djali: Muhamedi a.s. a ka migruar para shokëve të tij apo pas shokëve të tij?

Babai: Pejgamberi a.s. në rend të parë i ka përcjellë shokët të cilët kanë shkuar në Medine pastaj i fundit ka migruar në Medine.

Djali: Kur ka migruar Muhamedi a.s., a ka pas shoqërues?

Babi: Po, e ka pas shokun e tij Ebu Bekri Siddikin.

Djali: Si e kanë pritë Muhamedin a.s në Medine?

Babai: E kanë pritë me padurim ashtu që janë tubuar pleq e të rinj, ndërsa fëmijët dhe vajzat kanë dalë duke kënduar:

“Agoi hëna katërmbdhjetëshe, në atë vend të mirësisë
Sa të gëzuar po të presim faleminderit Perëndisë”

Djali: Çka ka vepruar pejgamberi a.s kur ka mbërri në Medine?

Babai: E ka bërë vëllazërimin e fisit Evi të Medinës dhe fisin Hazrexi të Medinës të cilët e kishin pranuar Islamin.

Djali: A ka bërë edhe ndonjë vëllazërim tjetër?

Babai: Po, e ka bërë vëllazërimin e migruesve (Mekasëve) me vendasit (Medinasve).

Djali: Si janë quajtur Mekasët dhe si janë quajtur Medinasët?

Babai: Mekasët janë quajtur Muhaxhir (Mërgimtarë) ndërsa Medinasët janë quajtur Ensarë (Ndihmëtarë).

Djali: Ku bëhej takimi i Muslimanëve në Medine?

Babai: Pas Migrimit Muhamedi a.s. e ka ndërtuar xhaminë e cila e luante edhe rolin e adhurimit edhe rolin e takimit të Muslimanëve.

Në fund babi i thotë djalit:

Hixhret (migrim) nuk do të thotë vetëm migrimi fizik nga një vend në një vend tjetër por hixhret do të thotë edhe të larguarit nga Harami dhe nga punët e këqija.

DJALI E PYET BABAIN PËR SEXHDËN

Djali: Çka do të thotë Sexhde?

Babai: Sexhde do të thotë PËRULJE.

Djali: E çka do të thotë PËRULJE?

Babai: Sexhde (Përlje) do të thotë me e vendosë ballin në tokë me gjithë shuplaka, gjunjët dhe këmbët.

Djali: Si duhet rënë në SEXHDE?

Babai: Në rend të parë vendosën gjunjët në tokë, pastaj duart, pastaj ballin dhe në fund hundën.

Djali: Sa lloje të sexhdeve i kemi?

Babai: Kemi sexhde të namazit dhe sexhde jashta namazit.

Djali: Cilat janë sexhdet e namazit?

Babai: Sexhdet e namazit janë:

- Sexhdja farz e namazit dhe
- Sexhdja e harresës.

Djali: Cilat janë sexhdet jashtë namazit?

Babai: Sexhdet jashtë namazit janë:

- Sexhde të leximit të Kur'anit;
- Sexhde të falënderimit;
- Sexhde për lutje.

Djali: Ku është dallimi i sexhdeve tjera me sexhden e namazit?

Babai: Në sexhde të namazit dy sexhde e përbëjnë një sexhde, ndërsa në rastet tjera një sexhde mjafton.

Djali: A ka edhe ndonjë dallim tjetër?

Babai: Në sexhde të namazit nëse lutesh për ndonjë të mirë të kësaj bote prishet namazi ndërsa në sexhdet tjera jashtë namazit ke të drejtë të lutesh edhe për të mirat e kësaj bote.

Djali: Çka thuhet në sexhde të namazit?

Babai: Në Sexhde të namazit thuhet tri here në sexhde “Subhane Rabbiel eala” .

Djali: Kur bëhet sexhde falënderimi?

Babai: Sexhdja e falënderimit bëhet atëherë kur të ndodh ndonjë mirësi ose të largohet ndonjë fatkeqësi si f.v: kur e jep diplomon, kur punësohesh, kur Zoti të gëzon me fëmijë e kështu me radhë.

Djali: Çka thuhet në sexhden e falënderimit?

Babai: Në sexhde mund të thuash: “Subhane Rabijel eala tri herë, pastaj e falënderon Zotin për atë mirësi me të cilën të ka gëzuar.

Djali: Çka thuhet në sexhde të leximit të Kur’anit?

Babai: E thua lutjen si në vijim: “I ra në sexhde fytyra ime Allahut, i Cili na ka dhënë dëgjimin, shikimin.. E këtë e ka bërë vetëm fuqia e Tij. Lavdërimi i takon Allahut Krijuesit më të Mirë.”

Djali: Sa sexhde të leximit gjinden në Kur’an?

Babai: Në Kuran i kemi 14 sexhde të leximit të Kur’anit.

Babai: A mund të bëj sexhde dhe në sexhde të bëjë lutje?

Babai: Po! Sikurse bënë lutje duke i ngritë duart lartë në qiell mund të bësh lutje edhe në sexhde e cila sexhde në këtë rast nuk është sexhde e namazit por sexhde dhe lutje.

DJALI E PYET BABAIN PËR SALA(VA)TIN

Djali: Çka quajmë Koprrac?

Babai: Fjala koprrac ka dy kuptime.

Djali: Cilat janë ato dy kuptime?

Babai: Kuptimi konkret dhe kuptimi abstrakt.

Djali: Cili është kuptimi konkret?

Babai: Kur ke pasuri dhe nuk ju ndihmon të tjerëve.

Djali: Cili është kuptimi abstrakt?

Babai: Koprrac është ai, pran të cilit përmendet emri i Muhamedi a.s. dhe nuk i dërgon sala(va)te, nuk e përshëndet dhe nuk i dërgon selame të dashurit tonë Muhamedit a.s.

Djali: Çka do të thotë salat?

Babai: Salat do të thotë: lutje. Pra, Fjala salat (shumësi: salavat) nënkupton duatë që i bëjmë për Muhammedin a.s.

Djali: Çka do të thotë Salat ve selam?

Babai: Atëherë kur lutjes ia bashkëngjisim edhe përshëndetjen për Muhamedin a.s quhet: Es-salatu edhe es-Selam. Zoti i Madhërishëm thotë: INELL-LLAAHE VE MELAAAIKETEHU JUSAL-LUUNE ALEN NEBIJ.

JA EJJUHEL-LEDHINE AAMENUU SAL-LUU ALEJHI

SAL-LUU ALEJHI VE SEL-LIMUU TESLIMEN

Djali: Çka nënkupton salati i Allahut për Muhamedin a.s.

Babai: Salati i All-llahut xh.sh. për Muhammedin a.s. nënkupton faljen e mëkateve.

Djali: Çka nënkupton salati i melekëve për Muhamedin a.s

Babai: salati i melekëve për të, nënkupton lutjen për falje të mëkateve për Muhamedin a.s

Djali: Çka nënkupton salati i besimtarëve për Muhamedin a.s

Babai: salati i besimtarëve nënkupton lutjen për ngritjen e shkallëve (dërxheve) dhe vlerës së Muhamedit .a s në këtë botë dhe në botën tjetër.

Djali: A ka forma apo lloje të Sala(va)teve?

Babai: Ka forma apo lloje të ndryshme të Sala(va)teve, e prej tyre kemi: Salavatit Ibrahimije, Sala(va)tin Tefrixhije (tejkalimit të një vështirësie), Sala(va)t (shpëtimit dhe suksesit) e kështu më radhë.

Djali: Cili është Salavati Ibrahimije

Babai: Sala(va)ti Ibrahimije është Salavati në namaz si në vijim.

All-llahumme sal-li ala Muhammedin ve ala ali Muhammed.

kema salejte ala Ibrahimie ve ala ali Ibrahimë

Inneke Hamidun Mexhid,

All-llahumme barik ala Muhammedin ve ala ali Muhammed

kema barekte ala Ibrahimie ve ala ali Ibrahimë

Inneke Hamidun Mexhid.

(O Allah bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit ashtu siç bekoje Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit.

Me të vërtetë Ti je i Lavdëruar e Famëlartë

O Allah bekoje Muhammedin dhe familjen e Muhammedit ashtu siç bekoje Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit.

Me të vërtetë Ti je i Lavdëruar e Famëlartë).

Djali: Pse dërgojmë sala(va)te për Muhamedin a.s.?

Babai: Për të fituar shefaatin (ndërmjetësimin) e Muhamedit a.s. në ditën e gjykimit Muhamedi a.s. ka thënë: “Kush dërgon salavat mbi mua çdo mëngjes dhe çdo mbrëmje, ai person do ta fitojë shefatin (ndërmjetësimin) tim Ditën e Gjykimit.”

DJALI E PYET BABAIN PËR TALKININ

Djali: Çka do të thotë TALKIN?

Babai: TALKIN do të thotë rikujtim.

Djali: Kujt i bëhet ky rikujtim?

Babai: Ky rikujtim(TALKIN) i bëhet dy personave:

1. Personit të sëmurë në shtratin e vdekjes dhe
2. Të vdekurit pasi të varroset.

Djali: A i këndohet TALKINI të gjallit.

Babai: Po! I kujtohet të sëmurit në shtratin e vdekjes që të thotë Shehadetin.

Djali: Po a ka ndonjë rast tjetër

Babai: Edhe fëmija kur të lindë i këndohet EZANI në veshin e djathtë dhe IKAMETI në veshin e majtë, që do të thotë i këndohet SHEHADETI.

Djali: A i rikujtohet TALKINI jo besimtarit?

Babai: Jo! Pabesimtari thirret në Islam para vdekjes.

Djali: Po pas vdekjes a i këndohet TALKINI jobesimtarit?

Babai: Edhe po t'i thirrej nuk do t'i bënte dobi.

Djali: Pse nuk i bënë dobi?

Babai: Sepse Shehadeti e ka vlerën para vdekjes. Pabesimtari edhe nëse e thotë shehadetin pas vdekjes nuk i pranohet te Zoti.

Djali: A dëgjon i vdekuri?

Babai: Po! Dëgjon sikurse i gjalli vetëm se nuk ka mundësi të përgjigjet.

Djali: Çka i rikujtohet kur i këndohet TALKINI?

Babai: I rikujtohet se Allahu është Zoti i tij;

Muhamedi a.s. peygamberi i tij;

Islami feja e tij dhe

Kur'ani udhëzuesi i tij.

Djali: A kemi detyra ndaj të vdekurit

Babai: Po! Kemi detyrë të lutemi për të.

Djali: Kur të kalojmë pranë varrezave çka duhet thënë?

Babai: Kur të kalojmë pranë varrezave themi: “Esselamu ala ehli-dijari minel-muëminine vel-muslimine ve jarhamullahu el-mustekdimine minna vel-musteëhirinë. Ve inna in shaa Allahu bikum lelahikunë.

Që do të thotë: “Selami qoftë mbi banorët e këtyre banesave (varreve) prej besimtarëve dhe muslimanëve. Allahu i mëshiroftë ata që na paraprinë edhe ata që do të vijnë më vonë. Edhe ne, me vullnetin e Allahut, do t’iu pasojmë juve.”

DJALI E PYET BABAIN PËR MEKAMIN IBRAHIM

Djali:Çka do të thotë Mekami Ibraim?

Babai:Pozicioni i Ibrahimit a.s., me fjalë tjera vendqëndrimi i Ibrahimit a.s.

Djali: Ku gjendet mekami Ibrahim?

Babai: Afër Qabës së bekuar.

Djali: Pse e ka marrë këtë emër?

Babai: Në këtë vend ka qëndruar Ibrahim a.s. kur i ka ngritë themelet e Qabës.

Djali: Kush i ka ndihmuar Ibrahimit a.s. kur i ka ngritë themelet e Qabës?

Babai: Djali i tij Ismaili a.s.

Djali: Si i ka ndihmuar Ismaili?

Babai: Ibrahim a.s. ka qëndruar lartë (si në skele), ndërsa djali i tij Ismaili ia ka ofruar materialin ndërtimor nga poshtë.

Djali: Çka ka vepruar Ibrahim pasi e ka përfunduar Qabën?

Babai: Ka hipur në këtë gurë, në këtë vendqëndrimi cili ka qenë i ngritur si skele dhe e ka thirr njerëzimin për ta kryer Haxhin.

Djali: A ka bë ndonjë veprim tjetër?

Babai: Ibrahim a.s. me djalë e tij Ismailin kanë bë lutje.

Djali: Çka bënë haxhiu pasi ta kryen Tavafin?

Babai: I falë dy rekate namaz në këtë vend.

Djali: Imami qëndron në Mihrab kur e falë namazin me xhematë. E ku qëndron Imami i Qabës kur e fal namazin me xhematë pasi i gjithë xhemati falen nga të gjitha anët?

Babai: Imami i Qabës qëndron te mekamu Ibrahim.

Në fund djali i thotë babait: Babi im! Edhe unë do të të ndihmoj ty ashtu siç i ka ndihmuar djali Ismail babait të tij Ibrahimit a.s.

DJALI E PYET BABAIN PËR MIRATHIN

Djali: Çka do të thotë Mirath?

Babai: Mirath do të thotë trashëgimi.

Djali: Nuk po e kuptoj fjalën trashëgimi?

Babai: Trashëgimi do të thotë atëherë kur pas vdekjes sime bëhet bartja e pronës në emrin tënd.

Djali: Bartja e pronës bëhet vetëm në emër tim apo?

Babai: Bartja e pronës bëhet edhe në emër të motrës tënde.

Djali: Kam dëgjuar se Mirazi (Mirathi) të cilën e merr motra është haram?

Babai: Jo! Haram kanë bë ata të cilët kanë thënë se Mirazi (Mirathi) është haram.

Djali: Po nga e kanë marrë atë mendim?

Babai: Nga kanuni i cili është në kundërshtim me ligjin e fesë Islame.

Djali: A ka edhe ndonjë kuptim tjetër fjala Mirath?

Babai: Po biri im. Mirathi ka kuptim konkret dhe kuptim abstrakt.

Djali: Cili është kuptimi konkret i Mirathit?

Babai: Kuptimi konkret është bartja e pasurisë nga i vdekuri tek i gjalli.

Djali: Cili është kuptimi abstrakt i Mirathit?

Babi: Kuptimi abstrakt është bartja e fesë dhe edukatës nga i vdekuri te i gjalli.

Djali: A janë trashëguar pejgamberët?

Babai: Jo. Pejgamberët nuk janë trashëguar, e gjithë pasuria materiale e tyre i mbetet shoqërisë.

Djali: Por a është trashëguar dituria e tyre?

Babai: Po. Prej pejgamberëve është trashëguar vetëm dituria dhe edukata e tyre.

Djali: Kush janë trashëgimtarë të pejgamberëve?

Babai: Trashëgimtarë të pejgamberëve janë dijetarët. Pejgamberët nuk kanë lënë as dërhëm e as dinarë, por kanë lënë pas vete diturinë, e kush e merr atë dituri e ka marrë pjesën më të mirë.

Në fund djali i thotë babës: Babi! Unë do të trashëgojë edukatën tënde, do të trashëgojë fenë tënde, do t'i trashëgoj të mirat tua me të cilat jam rritur dhe jam edukuar dhe do ta trashëgoj diturinë e pejgamberëve.

Ndërsa Babai thotë: Zekerija a.s. kur e ka arritë moshën e pleqërisë nuk është brengosë për trashëgiminë (Mirathin) e pasurisë por është brengosë për trashëgiminë (Mirathin) e fesë së tij. Për këtë arsye Zoti e ka shpërblye me një djalë në moshën e pleqërisë të cilin e ka emëruar me emrin Jahja. Andaj, unë nga sot, nëse vdes do të jam i qetë në botën tjetër.

DJALI E PYET BABAIN PËR FESTAT ISLAME

Djali: Sa festa Islame i kemi?

Babai: Dy festa biri im.

Djali: Cilat janë ato dy festa?

Babai: Festa e fitrit dhe festa e kurbanit.

Djali: Çfarë koncepti kanë festat islame?

Babai: Festat Islame kanë koncept të adhurimit ndaj Allahut dhe të humanizmit.

Djali: Kur është festa e Bajramit të Fitrit?

Babai Pas përfundimit të muajit të Ramazanit.

Djali Kur është festa e bajramit të Kurbanit?

Babai: Në kohën e kryerjes së haxhit.

Djali: Kur kryhet haxhi?

Babai: Në Muajin Dhul Hixhe, që do të thotë: Muaji i Haxhit.

Djali: Në cilën datë të muajit të muajit të haxhit?

Babai? Në ditën e dhjetë të Muajit dhul Hixhe (muajit të haxhit).

Djali: A ka dallim në mes të festave islame dhe festave jo Islame?

Babai: Po biri im, ka dallim.

Djali: Cili është ai dallim?

Babai: Festat tjera nuk ndërlidhen me adhurim ndaj Allahut, ndërsa festat Islame ndërlidhen me adhurim ndaj Allahut.

Djali: Me çka zbukurohen festat Islame?

Babai: Festat Islame zbukurohen me TEKBIRE. Muhamedi a.s ka thënë: “Zbukuroni festat e juaja me TEKBIRE”

Djali: Po a nuk zbukurohen me veshje të rrobave të mira?

Babai: Veshja e bukur në trupin tënd e ka kuptimin vetëm atëherë kur edhe i varfëri ka mundësi të vishet me rroba të mira.

Djali: Atëherë cila do të ishte zgjidhja?

Babai: Për këtë arsye, jepen fitrat e fitër bajramit, pastaj edhe zekati dhe ndihmat tjera vullnetare.

Djali: Në Bajram e shtrojmë drekën e Bajramit dhe pastaj kemi edhe Bakllavën dhe ëmbëlsira tjera.

Babai: Ushqimi i mirë në këtë ditë e ka vlerën atëherë kur ushqehen edhe të varfrit.

Djali: E si duhet të zgjidhet ky problem?

Babai: Me prerje të Kurbanit dhe të ushqyerit e të varfëve ashtu që të bëhet shprehi që edhe gjatë vitit të ushqehen të uriturit. Muhamedi a.s. ka thënë: ***“Nuk është besimtar ai i cili fletë i ngopur ndërsa fqinji i tij vuan nga uria”***

Djali: Si veprohet në festën e bajramit të fitrit dhe të Kurbanit?

Babai: Pasi të agon dita, babi nëna dhe fëmijët të gjithë së bashku shkojnë dhe e falin namazin e bajramit.

Djali: Po a nuk shkojnë për falje të bajramit vetëm burrat?

Babai: Jo biri im! Në namazin e bajramit ashtu siç e kanë obligim burrat e kanë obligim edhe gratë. Baballarët, Nënat, vëllezërit dhe motrat që të gjithë së bashku shkojnë dhe e falin namazin e Bajramit. Bajrami është edhe Panair Islam.

Djali: Babi e kuptova se duhet ta zbukurojmë Bajramit me rroba të bukura dhe se duhet t'i gëzojmë të tjerët me zekatul fitrin, e kuptova se duhet të ushqehen edhe të varfrit me mishin e Kurbanit, po a ka edhe ndonjë gjë tjetër e cila e zbukuron Bajramin.

Babai: Të tregova edhe më herët, Bajramet zbukurohen edhe me TEKBIRE.

Djali: A më tregon formulën e TEKBIRIT?

Babai: Po biri im, Tekbiri thuhet si në vijim:

Allaahu Ekber, Allaahu Ekber. Laaailahe il-lallaahu, Vallahu Ekber, Allaahu Ekber ve lil-lahil hamd.

Në përkthim do të thotë: Allahu është më i Madhi, Allahu është më i Madhi. Nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe Allahu është më i Madhi. Allahu është më i Madhi. Lavdërimi, madhërimi dhe falënderimi i takojnë vetëm Allahut.

Në fund babai i përsëriste tekbiret deri sa ia mësoi djalit të tij.

DJALI E PYET BABAIN PËR ARAFATIN

Djali: Çka është ARAFATI?

Babai: ARAFATI është kodër në Mekën e bekuar.

Djali: Sa është larg ARAFATI nga Qabja?

Babai: 22 km.

Djali: A përmendet në Kur'an kodra e ARAFATIT?

Babai: Po përmendet në Kur'an. Zoti madhërishëm thotë:

“Dhe pasi të keni qëndruar dhe jeni shpërnda nga ARAFATI përmendeni Zotin edhe në vendin e shenjtë (në Muzdelife)” (El-Bekare: 198)

Djali: Cilëve ju referohet ky ajet Kur'anor?

Babi: Ju referohet haxhilerëve deri në ditën e gjykimit.

Djali: A është pjesë themelore e Haxhit qëndrimi në ARAFAT?

Babi: Po. Muhamedit a.s.: **“Haxhi në tërësi është haxh së bashku me qëndrimin në ARAFAT”**.

Djali: Kur është koha e qëndrimit në ARAFAT?

Babi: Koha e qëndrimit në Arafat është dita e 9-të e muajit Dhul Hixhe.

Djali: Çka ndodhë nëse qëndrohet para kësaj date dhe nuk qëndron haxhiu në ARAFAT?

Babi: Nëse qëndron në ARAFAT para apo pas kësaj dite haxhi nuk pranohet.

Djali: Prej cilit moment të ditës së 9- të Dhul Hixhes duhet të qëndron në ARAFAT?

Babai: Koha fillon prej agimit të ditës së 9-të të muajit Dhul Hixhe dhe përfundon me agimin e ditës së 10 -të të muajit Dhul Hixhe.

Djali: Çka ka ndodhë përgjatë historisë në ARAFAT?

Babi: Thuhet së në këtë kodër janë njoftuar përsëri Ademi me Havanë pasi kanë zbrit në tokë prej xhennetit.

Djali: Çka do të thotë ARAFAT?

Babi:ARAFAT do të thotë:”kuptim” ngjashëm sikurse ti kur kupton diçka. Kjo sepse Ibrahim i ka kuptuar se ëndrra ka qenë urdhër prej Allahut për ta bë Kurban djali e tij Ismail.

Djali: Çka ka ndodhë pas ditës së 9 të dhul Hixhes?

Babi: Ibrahim i në mbrëmje ka shkuar në Muzdelife, ka fjetur një natë, pastaj në mëngjes në ditën e dhjetë të Dhul Hixhes ka dashur ta bën Kurban Ismailin në vendin e quajtur Mine.

Djali: A e ka bë Kurban djalin?

Babi: Jo. Zoti i ka shpërblye me një dash të Xhennetit dhe kanë bë Kurban dashin e Xhennetit.

Djali: Ne të cilët nuk kemi mundësi të shkojmë në haxh dhe të qëndrojmë në ARAFAT çka është mirë të bëjmë në ditën e ARAFATIT.

Babi: Muhamedi a.s ka thënë:

“Kush e agjëron ditën e ARAFATIT ka shpërblim sikurse ta kishte agjëruar vitin e kaluar dhe sikurse e agjëron edhe vitin në vijim.”

Djali: Babi! Unë kam vendos të agjëroj ditën e 9-të Dhul Hixhes, pra, ditën e ARAFATIT.

Babai i thotë: Pastaj biri im! Një ditë pas ditës së ARAFATIT do ta presim kurbanin në ditën e KURBANIT dhe do t'i gëzojmë nevojtarët dhe familjarët.

DJALI E PYET BABAIN PËR BID'ATIN

Djali: Çka do të thotë Bid'at?

Babai: Bid'at do të thotë ajo çka është e re ,ajo e cila nuk është veprue në të kaluarën.

Djali: Babi, unë po pyes për Bid'atin në Islam?

Babai: Bid'ati në Islam është çdo veprim, praktikë apo shprehje e cila nuk është në Kur'an, Sunet dhe Ixhmaë.

Djali: A është i ndaluar Bid'ati?

Babai: Jo çdo Bid'at është i ndaluar biri im!.

Djali: Po a nuk ka thënë Muhamedit a.s.: “çdo shpikje është bid'at, çdo Bid'at është devijim dhe çdo devijim shpie në zjarr.”

Babai: Jo biri im!Pjesa e hadithit: “Çdo shpikje është Bid'at”, ka për qëllim çdo veprim dhe praktikë e cila është në kundërshtim me bazat e sheriatit dhe e cila nuk është në përputhshmëri me sunetin e Muhamedit a.s.

Djali: Babi po a nuk ka thënë Muhamedit a.s.: “Ai që shpik në këtë fe diçka që s'është pjesë e saj, do të jenë të refuzuar.” !?

Babai: Jo biri im! Ky hadithë nuk tregon se çdo Bid'at është devijim në të gjitha veprimet dhe aktivitetet sepse Bid'ati ndonjëherë është i lavdëruar, e ndonjëherë është i përbuzur, kur dihet se në një hadithë Muhamedi a.s. ka thënë: “Kush vendos një praktikë të mirë, do të ketë shpërblim për të çdo herë që e vepron ndokush atë praktikë gjatë jetës së tij dhe pas vdekjes derisa të mos punohet ai veprim, dhe kush e vendos një praktikë të keqe do të bart mëkatën e saj, derisa të mos veprohet ai veprim.” Thënia e Muhamedit a.s. “një praktikë e mirë” d.m.th. një rrugë e pranuar të cilën e ndjekin njerëzit. Hadithi tregon se ka praktika dhe veprime të mira ashtu siç ka veprime dhe praktika të këqija.

Djali: Si ta dallojmë në mes të veprimit të mirë dhe veprimit të keq?

Babai: Nëse një veprim përputhet me bazat e sheriatit, është i lavdëruar, ndërsa nëse një veprim nuk përputhet me bazat e sheriatit është i përbuzur.

Djali: Cili është kandari i vërtetë i përcaktimit të Bid'atit në të mirë dhe atij të keq?

Babai: Kandari i vërtetë i përcaktimit të Bid'atit në të lavdëruar apo të përbuzur është sheriatu:

- Bid'at i mirë është ajo që është në harmoni me bazat e sheriatit, edhe nëse kjo është një çështje e re e cila është brenda rregullave të sheriatit dhe kuptimit të përgjithshëm të ajeteve dhe haditheve. Për këtë arsye, ajo vepër quhet e mirë dhe ka shpërblim dhe shpërblimi vazhdon edhe pas vdekjes.

- Bid'at i keq është ai veprim apo ajo praktikë e cila është në kundërshtim me rregullat e sheriatit, pra veprimet dhe praktikat e këtij lloji janë bid'at i përbuzur dhe i devijuar.

Djali: A më sqaron edhe njëherë dallimin ndërmjet Bid'atit të mirë dhe Bid'atit të keq?

Babai: Po Biri im:

- ajo që nuk është pjesë e fesë dhe që është në kundërshtim me rregullat e sheriatit, ai veprim dhe ajo praktikë konsiderohet e refuzuar dhe e devijuar;

- ajo që është pjesë e fesë dhe ka mbështetje në parimet e fesë është e pranueshme dhe është një veprim dhe praktikë e mirë.

Pastaj:

- ajo që përputhet me Kur'anin dhe me sunetin është e lavdëruar.

- ajo çka është në kundërshtim me atë që ka urdhëruar Allahu dhe i dërguari i Tij, ai veprim dhe ajo praktikë llogaritet bid'at i përbuzur.

Pastaj:

- ajo çka është brenda kornizës të cilën Allahu e ka konsideruar të pëlqyer dhe ku Allahu dhe i dërguari i Tij kanë nxitur drejt saj, atëherë ai veprim apo ajo praktikë bën pjesë brenda kornizës së lavdërimit.

- ajo çka është në kundërshtim me atë që ka urdhëruar Allahu dhe i dërguari i Tij, ai veprim apo ajo praktikë llogaritet bid'at i përbuzur.

Djali: Si ndahet Bid'ati?

Babi: Sikurse edhe çshtjet tjera ashtu edhe Bid'ati ndahet në:

- Bid'at vaxhib (obligativ);
- Bid'at haram (të ndaluar);
- Bid'at mendub (i pëlqyer);
- Bid'at mekruh (i urryer);
- Bid'at mubah (i lejuar).

Djali: A mund të më tregosh ndonjë shembull të bid'atit vaxhib?

Babai: Bid'ati vaxhib është mësimi dhe studimi gramatikor i gjuhës arabe, pa të cilin studim nuk mund të kuptohet fjala e Allahut dhe të dërguarit të Tij.

Djali: Pse është vaxhib (obligativ) Bid'ati i të mësuarit të gramatikës së gjuhës arabe?

Babai: Biri im! Për t'u ruajtur dhe për t'u siguruar sheriatin, është i patjetërsueshëm mësimi i gjuhës arabe. Rregull e fikhut është: Veprimi me të cilin plotësohet obligimi është obligim. Omeri r.a. ka thënë: "Mësojeni gjuhën arabe se mësimi i saj e zhvillon mendjen dhe moralin."

Djali: Cili është Bid'at haram?

Babai: Prej Bid'ati haram është të debatohet për çështjen e kaderit. Ky është debat i cili shkakton dhënie të mendimit pa njohuri sepse kaderi i Zotit është çështje e panjohur për njeriun.

Djali: Cili është Bid'ati Mendub?

Babai: Prej Bid'atit të mendub është themelimi i institucioneve arsimore në të gjitha nivelet arsimore. Pra:Themelimi i shkollave fillore pastaj shkollave të mesme pastaj univerzitare e kështu me radhë.

Djali: A ka edhe Bid'at të pëlqyer?

Babai: Bid'at i pëlqyer është edhe falja e namazit të teravive në xhami me imam (me xhemat). Kur Omeri r.a. i ka parë sehabet të bashkuar për namaz të teravive në ramazan në xhami pas një imami, ka thënë: “Sa i mirë është ky Bid'at!”

Djali: Po Bid'ati Mekruh?

Babai: Prej Bid'atit mekruh është zbukurimi i tepërt i Xhamive.

Djali: Cili është Bid'ati i lejuar?

Babai: Bid'ati i lejuar është llojllojshmëria në ushqime, lloj-llojshmëria në veshmbathje, etj.

VAJZA E PYET NËNËN PËR HIXHABIN

Vajza: Çka do të thotë HIXHAB?

Nëna: Hixhab do të thotë mbulesë.

Vajza: Çka nënkuptojmë me fjalën mbulesë?

Nëna: Mbulesë nënkupton mbulesa e cila e mbulon bukën për ta mbrojtur bukën nga insektet.

Vajza: E çka nënkuptojmë me fjalën HIXHAB ISLAM.

Nëna: Të mbuluarit e femrës besimtares trupin e saj.

Nëna: E çka do të thotë NIKAB

Babai: Fjala NIKAB ka kuptimin e të mbuluarit e femrës besimtare tërë trupin e saj pa ndonjë përjashtim.

Vajza: Ku është dallimi në mes të HIXHABIT dhe NIKABIT?

Nëna: HIXHAB do të thotë:

- të mbuluarit e trupit përpos duarve deri te nyje,
- të mbuluarit e trupit përpos fytyrës prej veshit deri në vesh dhe prej ku dalin flokët dhe nën mjekërr dhe

Të mbuluarit e këmbëve deri te zogu i këmbëve, ndërsa

NIKAB do të thotë të mbuluarit e trupit si dhe mbulimi i fytyrës po ashtu edhe mbulimi i këmbëve dhe i duarve.

Vajza: Ku bazohet çështja se HIXHABI është farz dhe jo NIKABI?

Nëna: Pjesa e ajetit "...Përpos asaj çka shihet..." (en-Nurë,31), e ajo çka shihet ka kuptimin e mosmbulimit të fytyrës, mosmbulimin (mos veshjen e dorëzave) e duarve dhe mosmbulimin e këmbëve deri te zogu i këmbës.

Vajza: Babi a nuk i ka thënë pejgamberi a.s. Aishes: Oj Aishe atëherë kur femrës i vijnë menstruacionet nuk lejohet t'i shihen përpos kjo dhe kjo

Babai: Po bija ime, kjo thënie e Pejgamberi a.s. e sqaron pjesën e ajetit, sepse me fjalët “kjo dhe kjo” ka pas për qëllim duart fytyrën dhe këmbët deri te zogu i këmbës.

Vajza: Nga cila moshë vajza duhet ta vendosë HIXHABIN?

Nëna: Varet prej një vajze te ndonjë vajzë tjetër, por e vërteta është se Hixhabi vendoset prej momentit kur vajzës i vijnë menstruacionet për të parën herë.

Vajza: Prej cilit moment duhet të vendoset HIXHABI?

Nëna: Prej momentit kur i vijnë femrës menstruacionet për të parën herë. Te ndonjë vajzë në moshën 13 vjeçare, te ndonjë vajzë tjetër në moshën 15 vjeçare e te ndonjë vajzë tjetër në moshën 17 vjeçare.

Vajza: A do të thotë se prej atij momenti femra e arrin moshën e pjekurisë?

Nëna: Po bija ime, pejgamberi a.s i ka thënë Aishes: “Oj Aishe atëher kur femrës i vijnë menstruacionet...” Pra, prej atij momenti e vendosë HIXHABIN.

Në fund vajza i thotë: Nënë dhe Babë: Kur të arrij në këtë moshë do ta barti HIXHABIN, do ta praktikoj veshjen Islame dhe do të krenoheni me mua Babi im dhe Nëna ime!.

DJALI E PYET BABAIN PËR “GUSULIN”

Djali: Çka është GUSULI?

Babai: GUSULI është pastrim sheriatik.

Djali: Ashtu sikurse më pastronte nëna kur isha i vogël?

Babai: Jo biri im, ai lloj pastrimi nuk quhet GUSËL, ajo është larje dhe pastrim i rëndomtë.

Djali: Pse a ka lloje të ndryshme të pastrimit?

Babai: Po kemi pastrimin e rëndomtë dhe pastrimin sheriatik.

Djali: Cili është pastrimi i rëndomtë?

Babai: Kur pastrohemi në banjë, në lumë, etj.

Djali: A mund të marrim GUSUL kur lahemi në lumë?

Babai: Po, vetëm se duhet ta pastrosh gojën deri në fyt dhe hundën deri në thellësi. Pastaj kjo larje në lumë konsiderohet GUSUL dhe mund të falesh.

Djali: A ma tregon definicionin e GUSULIT.

Babai: Gusuli është pastrimi i tërësishëm i trupit nga nevoja e madhe (papastërtia), për t'iu lejuar muslimanit me falë namazin dhe me i krye detyrat tjera të adhurimit në islam.

Djali: Kur pastrohemi me pastrim sheriatik?

Babai: Kur të plotësohet kushti për t'u pastruar për të krye ndonjë obligim sheriatik.

Djali: Kur e kam obligim për të parën të marrë GUSUL?

Babai: Atëherë kur të hysh në moshën e pjekurisë, me fjalë tjera të bulugut (Pubertetit).

Djali: Kur është ajo moshë?

Babai: Ajo varet prej personit në një person tjetër te disa persona mund të jetë në moshën 12 te disa në moshën 15 te disa në moshën 17 vjeçare.

Djali: Kur e kam për obligim në raste tjera?

Babai: GUSULI bëhet obligim në këto raste: Ejakulimi, apo dalja e spermës prej organit seksual apo dalja e një lëngu të bardhë nga organi intim e që quhet spermë për shkak të ëndërrimit.

Djali: A ka edhe ndonjë rast tjetër?

Babai: Po kur burri kontakton intimisht me gruan.

Djali: Po për gra kur bëhet obligim?

Babai: Përpos rasteve të përmendura për gratë bëhet obligim kur bëhet ndërprerja e menstruacionit (hajdit) dhe kalimi i afatit prej 40 ditësh pas lindjes (nifasës).

Djali: A ka ndonjë rast kur GUSULI nuk merret vet?

Babai Po atëherë kur muslimani vdes muslimanët e pastrojnë dhe i japin gusël ashtu siç ka marrë gusël kur ka qenë i gjallë.

Djali: A mund të merret GUSUL edhe kur e jemi të pastër?

Babai: Po mund të merret GUSULI edhe kur jemi të pastër si p.sh.: Në ditën e Xhuma dhe në ditën e festave të Bajramit.

Djali: Si merret GUSULI?

Babai: Gojën dhe brendësinë e gojës së bashku me fytin me e pastrua mirë.

Hundën, brendësinë e hundës deri në asht me pastrua mirë.

Tërë trupin me e pastrua plotësisht.

Djali e përsëritë: Unë do të marrë GUSUL. Në rend të parë e shpërlaj gojën deri në fyt;

Pastaj e pastroj hundën deri në thellësi të saj;

Pastaj e pastroj tërë trupin duke mos lënë asnjë pjesë pa e pastruar.

Në fund babai i thotë djalit: Zoti i do të ata të cilët pendohen dhe ata të cilët janë të pastër.

DJALI E PYET BABAIN PËR MUHAMEDIN A.S.

Djali: Kush ka qenë Muhamedi?

Babai: Muhamedi a.s. ka qenë PEJGAMBER dhe i dërguar i Allahut.

Djali: A është marrë me ndonjë veprimtari tjetër përpos pejgamberisë?

Babai: Po, ka qenë BARI, ka ruajtur bagëtinë.

Djali: Pejgamberi BARI! Si është e mundur kjo?

Babai: Përpos që ka qenë Bari ka qenë edhe TREGTAR, ka bërë tregti të drejtë dhe të sinqertë.

Djali: A ka pas fëmijë Muhamedi a.s.?

Babai: Po, është martuar dhe ka pas djem dhe vajza të cilët i ka dashur shumë.

Djali: A është marrë me POLTIKË Muhamedi a.s.?

Babai: Po, Muhamedi a.s. ka qenë DIPLOMAT DHE POLITIKAN, e ka njohur shumë mirë si politikën kombëtare ashtu edhe politikën ndërkombëtare të asaj kohe.

Djali: A ka LUFTUE Muhamedi a.s.?

Babi: Po, Muhamedi a.s. ka qenë luftëtarë dhe Komndant suprem i forcave të armatosura të muslimanëve.

Djali: Pse, a kanë pas SHTET muslimanët?

Babai: Jo, në fillim muslimanët nuk kanë pasë shtet, por themelues i shtetit të muslimanëve është Muhamedi a.s..

Djali: A ka qenë GJYKATËS Muhamedi a.s.?

Babi: Po, Muhamedi a.s. ka qenë edhe GJYKATËS dhe ka pajtuar palët e konfrontuara.

Djali: A ka qenë UDHËHEQËS shteti Muhamedi a.s?

Babi: Po, mirëpo edhe pse ka qenë udhëheqës shteti, ka qenë i thjeshtë, e ka dashur jetimin, është ulur me të varfrin. Pozita e lartë shtetërore nuk ka ndikuar që ai të mos qëndroj me njerëzit e rëndomtë sepse: “Ai i cili është i thjeshtë me njerëzit Zoti e ngritë në pozitë të lartë”.

Në fund babai i thotë djalit vet:

“Biri im,

Muhamedi a.s është shembull dhe modeli më i miri:

- si për Bariun si për Tregtarin;
- si për të Martuarin si për Prindin;
- si për Politikanin si për Diplomat;
- si për Luftëtarin si për Komandantin;
- si për Qeveritarin ashtu edhe për Gjykatësin”.

DJALI E PYET BABAIN PËR NATËN E KADRIT

Djali: Pse quhet nata e kadrit?

Babai: Nga shkaku se kjo natë përmban ngjarjen më të rëndësishme të Zotit për historinë njerëzore.

Djali: Cila është ajo ngjarje më e rëndësishme e historisë njerëzore?

Babai: Ajo ngjarje e rëndësishme e historisë njerëzore është fillimi i zbritjes së Kur'anit.

Djali: A ka edhe ndonjë arsye tjetër për vlerën e kësaj nate?

Babai: Po, nga shkaku se në këtë natë zbresin Melaqet dhe Xhibrili i cili i ka sjell Kur'anit Muhamedit a.s.

Djali: Për çfarë arsye zbresin melaqet dhe Xhibrili?

Babai: Për çdo urdhrë prej urdhrave të Allahut të Madhërishëm.

Djali: A ka edhe ndonjë arsye tjetër pse zbresin melaqet në këtë natë?

Babai: Po, zbresin melaqet për ti përshëndesin me selam besimtarët me Selam

Djali: Çfarë kuptimi ka fjala Selam?.

Babai: Fjala “selam” përpos që është përshëndetje ka kuptimin e sigurimit nga çdo e keqe..

Djali: Pse e ka epitelin lejletul-Kadri?

Babai: Për shkak të përcaktimit dhe të programimit të çështjeve për vitin në vijim.

Djali: Cili është ai program dhe cilat janë ato çështje?

Babai: Në atë program përcaktohen furnizimet dhe të gjitha ngjarjet për vitin në vijim e pastaj melaqet e zbatojnë atë program për ato çështje.

Djali: Çka sjellë kjo natë për ne?

Babai: Kjo natë sjellë siguri nga çdo e keqe, sjellë qetësi, shëndet, në të pranohen lutjet, duke filluar nga fillimi i kësaj nate deri në agimin e mëngjesit të ditës tjetër.

Djali: Sa është e vlefshme kjo natë?

Babai: Është më e vlefshme se njëmijë net. Puna në këtë natë është më e mirë se puna e 1000 muajve.

Djali: Sa vite bëjnë 1000 muaj?

Babai: 1000 muaj është e barabartë me 83 vite e 4 muaj, përafërsisht sa jeta e çdonjërit.

Djali: Cilën lutje duhet ta bëjë në këtë natë?

Babai: Lutjen si në vijim:”Zoti im,Ti je Falës. E do faljen. Më fal mua”.

DJALI E PYET BABAIN PËR EBU HANIFËN?

Djali: Kush është Ebu Hanife?

Babai: Është emër i medhhebit HANEFIJ në Islam.

Djali: Me çka karakterizohet Ebu Hanife?

Babai: Karakterizohet se ka pas diapazon të thellë dhe të gjerë të diturisë.

Djali: A njihet tipare tjera?

Babai: Po njihet me atë se ka pas edukatë të lartë të moralit, është dalluar me modesti, me thjeshtësi, me drejtësi, me adhurim të shumtë, me burrëri dhe me karakter të fortë.

Djali: Cilës gjeneratë i takon Ebu Hanife?

Babai: Gjeneratës së TABIINËVE.

Djali: Pse i takon Gjeneratës së TABIINËVE?

Babai: Sepse është takuar me gjeneratën e artë, me gjeneratën e SEHABEVE të pejgamberit a.s..

Djali: A dihet ndonjë sehabë me të cilin është takuar Ebu Hanife?

Babai: Po, është takuar me sehabijun Enes Bin Malikun r.a.

Djali: Në çka është bazuar Ebu Hanife në diturinë e tij?

Babai: Në rend të parë është bazuar në Kur'anin Fisnik,

- Pastaj në hadithet pejgamberike
- Pastaj në analogjinë (Kijasin) e çështjeve me Kuran dhe me sunet.
- Pastaj në Ixhmain (Konsensusin) e sehabeve dhe me argumentet tjera të shariatit Islam.

Djali: Në cilin vit është lindur Ebu Hanife?

Babai: Në vitin 60 të Hixhretit.

Djali: Kur ka vdekur Ebu Hanife?

Babai: Në vitin 160 të Hixhretit.

Djali: A ka edhe Imam tjerë të Ehlu sunetit dhe Xhematit në sheriatit islam?

Babai: Po, botërisht dihen katër Imamët:

Imam Shafiiju,

Imam Malikiu,

Imam Ahmed bin Hanbeli të cilët kanë qenë imam të Ehlu sunetit dhe xhemaatit, ndërsa:

Ebu Hanife llogaritet të jetë Imami i parë i Ehlu sunetit dhe xhemaatit.

Sot në ditë xhumaje e përshëndesim dhe dërgojmë salavate për të dashurin tonë Muhamedin a.s.

DJALI E PYET BABAIN PËR HAXHIN

Djali: Çka do të thotë Qabe?

Babai: Qabe do të thotë objekt në formë Kube.

Djali: Çka do të thotë Bejtul Atikë?

Babai: Shtëpia e parë e paraparë për njerëzit për ta adhuruar Allahun.

Djali: Kur është ndërtuar Qabja?

Babai: Qabja i ka themelet para krijimit të njerëzimit.

Qabën e ka bë tavaf edhe Anija e Nuhut a.s

Qabën e ka bë tavaf edhe Hud-Hudi i Sulejmanit a.s. para se t’ia dërgonte letrën Belkisës, mbretëreshës së Sebeit me shkresën “BISMIL-LAHIRR-
RRAHAMANIRR-RAHIMË”

Djali:Pra, Kur është rindërtuar Qabja?

Babai:Themelet i ka ngrit një baba me djalin e tij.

Djali: Si quhej ai baba dhe si quhej djali i tij

Babai: Ai baba quhej Ibrahim ndërsa djali i tij quhej Ismail.

Djali: Çka kanë vepruar pasi e kanë rindërtuar Qabën?

Babai: Pasi i kanë ngritë themelet kanë bë lutje që ata dhe pasardhësit e tyre të bëhen të dorëzuar ndaj Zotit,me fjalë tjera të jen musliman.

Djali: A ka bë ndonjë veprim tjetër?

Babai: Po, ka thirr Ezan për të shkuar për të krye Haxhin.

Djali: E çka do të thotë Haxh?

Babai: Haxh do të thotë pikësnyim dhe vendosmëri për të krye diçka.

Djali: A nuk do të thotë vizitë?

Babai: Jo biri im, Haxhi nuk quhet vizitë edhe pse vizita në të është një pjesë prej pjesëve të haxhit.

Djali: Po cilat janë obligimet të të cilat duhet të kryhen gjatë Haxhit?

Babai: Përpos veshjes së Ihramit i cili është parakusht është kushtet e haxhit janë:

- Qëndrimi në kodrinën Arafat dhe
- Tavafi i Qabës.

Djali: A ka obligime tjera gjatë haxhit?

Babai: Po, janë edhe vaxhibet e Haxhit e ato janë:

- Qëndrimi në Muzdelife, në vendin ku ka e ka kaluar natën Ibrahim para se të vendoste të bënte djalin Ismaili Kurban.

- Qëndrimi në Mine në vendin ku ka dashur ta bënte Kurban djalin.

- Gjuajtja e guralecëve në Mine, të cilat gjuajtje konsiderohen gjuajtje simbolike ndaj shejtanit, ashtu siç e ka gjuajt Ibrahim a.s. shejtanin.

- Saëji, pra ecja nga Kodrina Safa deri në Merva ashtu siç ka ecë Haxherja për të kërkuar ushqim për djalin e saj Ismailin a.s. dhe

- Rruarja apo qethja e flokëve.

Djali: A ka edhe rregulla tjera Haxhi?

Babai: Po ka, por mjafton që t'i tregova farzet dhe vaxhibet ndërsa për rregulla tjera do të t'i tregoj kur të rritesh edhe pak biri im.

DJALI E PYET BABAIN PËR UMRE-N

Djali: Çka do të thotë UMRE?

Babai: Umre do të thotë bërja Tavaf rreth Qabes dhe ecja (SAËJI) mes kodrinave Sefa dhe Merva.

Djali: A bëhet UMREJA pa Ihram.

Babai: Jo, as Haxhi as Umre nuk bëhen pa Ihram sepse Ihrami është parakusht edhe i Haxhit edhe i Umre-s.a.v.s.

Djali: Çka do të thotë Ihram?

Babai: Ihrami për Haxh dhe Umre është sikurse abdesi për namaz. Ihram nuk nënkupton vetëm veshja e dy mbështjellësve të bardhë por edhe të larguarit nga shumë çështje të lejuara ashtu sikurse largohesh nga disa prej çështjeve të lejuara gjatë agjërimit.

Djali: Ku është dallimi në mes të Haxhit dhe Umre-s?

Babai: Haxhi bëhet në muajin e caktuar i cili muaj është muaji Dhul-hixhe, përderisa Umre-ja bëhet në çdo kohë gjatë gjithë muajve të vitit.

Djali: A ka ndonjë dallim tjetër?

Babai: Umre bëhet për disa orë ndërsa Haxhi për disa ditë dhe me më shumë detyra dhe obligime.

Djali: Prej sa pjesëve përbëhet Umre-ja?

Babai: Umreja përbëhet prej dy çështjeve themelore, e ato janë:

1. TAVAFI dhe
2. SAËJI.

Djali: Çka quajmë Tavaf?

Babai: Tavaf nuk e quajmë një rreth-rrotullim ndaj Qabës por shtatë rreth-rrotullime ndaj Qabës.

Djali: Çka do të thotë SAËJI?

Babai: SAËJ do të thotë ecje e rëndomtë nga një kodër e caktuar në kodër tjetër të caktuar.

Djali: Cilat janë ato dy kodrina?

Babai: Njëra kodrinë quhet kodrina SAFA tjetra quhet kodrina MERVA.

Djali: A quhet SAËJ vetëm një shkuarje nga Safa deri në Merva?

Babai: Jo, SAËJ quhet atëherë kur i bënë katër ecje (udhëtime) nga Safa deri në Merva dhe tri ecje (udhëtime) nga Merva deri në Safa.

Djali: Pse bëhet kjo ecje (Udhëtim-SAËJ)?

Babai: Ngase Haxherja ka ecë (ka bërë SAËJ) dhe ka vrapuar nga njëra kodër në tjetrën për t'i siguruar ushqim djalit të saj Ismailit.

Djali: Dhe me kaq përfundon Umre-ja?

Babai: Biri im, UMRE-ja përfundon me shkurtimin e flokëve ose me rruajtjen e kokës pasi të bëhet ECJA (SAËJI) në mes kodrinave Safa dhe Merva.

Djali: Po babi im, gjatë Umre-s a bëhet edhe Qëndrimi ditorë në Arafat, Qëndrimi në Muzdelife gjatë natës dhe gjuajtja e gurëve në Mine pas agimit sikurse në Haxh?

Djali: Jo biri im, këto veprime nuk kanë të bëjnë me Umre-n, këto veprime kanë të bëjnë vetëm me Haxhin dhe ky është dallimi kryesorë në mes të Haxhit dhe Umrë-s përpos dallimit kohorë.

DJALI E PYET BABAIN PËR KURBANIN

Djali: Çka do të thotë Kurban?

Babai: Kurban do të thotë :Të afruarit me Zotin!.

Djali: Po a nuk do të thotë Sakrificë!?

Babai: Jo, Kurban nuk do të thotë: Sakrificë!

Djali: Atëherë, pse po thuhet se Kurban do të thotë: Sakrificë!?

Babai: Afrimi me Allahun bëhet atëherë kur ti je në gjendje të sakrifikosh kohën për Zot;

- Afrimi me Allahun bëhet atëherë kur je në gjendje të sakrifikosh mundin për Zot;

- Afrimi me Allahun bëhet atëherë kur je në gjendje ta sakrifikosh pasurinë për Zot;

- Afrimi (Kurban) konsiderohet edhe kur e ther ndonjë kafshë shtëpiake për t'i ushqyer të varfrit, mirëpo as gjaku, as mishi nuk shkon te Zoti, por te Zoti shkon fjala e mirë dhe vepra e mirë.

Djali: Kur theret Kurbani?

Babi: Prej ditës së parë të Bajramit të Kurbanit deri në ditën e tretë të Bajramit të Kurbanit para perëndimit të diellit.

Djali: Si e shpërndanë mishin e Kurbanit?

Babi:

- Një pjesë për familje

- Një pjesë për të afërmit dhe

- Një pjesë për të varfrit.

DJALI E PYET BABAIN PËR KUR'ANIN

Djali: Cilin e ke shokun më të mirin?

Babai: Kur'anin.

Djali: Pse?

Babai: Nga shkaku se:

- Kur'ani është shoku i pandashëm i i imi,
- Kur'ani do të vjen me mua në varrë kur do të jem i vetmuar;
- Kur'ani do të më bashkëngjitet kur do të ringjallem;
- Kur'ani do të ndërmjetëson (do të bënë shefaat) për mua në ditën e gjykimit.

Përmbajtja:

DJALI E PYET BABAIN PËR ISRANË	4
DJALI E PYET BABAIN PËR MIRAXHIN	6
DJALI E PYET BABAIN PËR RAMAZANIN	9
DJALI E PYET BABAIN PËR ZEKATIN	12
DJALI E PYET BABAIN PËR NAMAZIN	15
DJALI E PYET BABAIN PËR SEHABET	18
DJALI E PYET BABAIN PËR "SELAMIN"	20
DJALI E PYET BABAIN PËR HIXHRETIN	23
DJALI E PYET BABAIN PËR SEXHDËN	26
DJALI E PYET BABAIN PËR SALA(VA)TIN	28
DJALI E PYET BABAIN PËR TALKININ	31
DJALI E PYET BABAIN PËR MEKAMIN IBRAHIM	33
DJALI E PYET BABAIN PËR MIRATHIN	35
DJALI E PYET BABAIN PËR FESTAT ISLAME	37
DJALI E PYET BABAIN PËR ARAFATIN	40
DJALI E PYET BABAIN PËR BID'ATIN	42
VAJZA E PYET NËNËN PËR HIXHABIN	46
DJALI E PYET BABAIN PËR "GUSULIN"	48
DJALI E PYET BABAIN PËR MUHAMEDIN A.S.	51
DJALI E PYET BABAIN PËR NATËN E KADRIT	53
DJALI E PYET BABAIN PËR EBU HANIFËN?	55
DJALI E PYET BABAIN PËR HAXHIN	57
DJALI E PYET BABAIN PËR UMRE-N	59
DJALI E PYET BABAIN PËR KURBANIN	61
DJALI E PYET BABAIN PËR KUR'ANIN	62